



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3431/11 prot.

Datë 24.12.2025

V E N D I M
Nr. 1911/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1839/2025, datë 11.12.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK me NIPT J63229466K, K13001010G dhe adresë: Fshati Suke i siperm, Nr 2, Rruga Strum - Suke, Km 3, Lagjja Zoga, Roskovec, Berat

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 11.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1839/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 146/2025 datë 05.12.2025 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike dhe të dërguar përmes shërbimit postar protokolluar me tonën respektivisht me nr. 3431/2 prot., datë 10.12.2025 dhe nr. 3431/3 prot., datë 11.12.2025.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr.4010/5 prot., datë 16.12.2025 me lëndë “Zbatim i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr.3431/8 prot., datë 11.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1839/2025 datë 11.12.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.4010/5 prot., datë 16.12.2025 me lëndë “Zbatim i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr.3431/8 prot., datë 11.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1839/2025 datë 11.12.2025.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK në përputhje me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin Nr.1839/2025 datë 11.12.2025 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin e KSHA-së së tij për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin Nr.1839/2025 datë 11.12.2025 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

